



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr 317/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej Vedat Poterqoi-Kryetar, Kimete Gashi- Referuese dhe z. Agon Ramadani- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatoreve ekonomik: "MERISA" SH.P.K.; NTSH VIKTORY COM (Pjeter Qërimi B.I); AEK MUNELLA SHPK; ECO SWISS RECYCLING" me seli në Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në zona rurale" me numër të prokurimi: 632-21-8072-2-2-1 dhe numër të brendshëm: 632-21-130-221, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, më datën: 08.11.2022, mori këtë:

VENDIM

- 1. Mbetet në fuqi** vendimi i AK-së njoftimit për dhënie të kontratës i datës **27.07.2022** dhe kontrata e datës: **28.07.2022**, e protokolluar me datën **28.08.2022** për aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në zona rurale" me numër të prokurimi: 632-21-8072-2-2-1 dhe numër të brendshëm: 632-21-130-221, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës.
- 2.** Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Ndërsa, obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Grupi i operatoreve ekonomik ankues “MERISA SH.P.K.;NTSH VIKTORY COM (Pjeter Qërimi B.I); AEK MUNELLA SHPK;ECO SWISS RECYCLING” me seli në Gjakovë si palë e pa kënaqur me datën 05.08.2022 ka parashtruar ankesë në OSHP , anesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër 317/2022, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në zona rurale” me numër te prokurimi: 632-21-8072-2-2-1 dhe numër te brendshëm: 632-21-130-221, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës , duke pretenduar që AK ka vepruar në kundërshtim me:1,6,7,56,59,60,69 dhe 72 të LPP-së.

- Kjo procedurë e prokurimit ka qene objekt shqyrtimi në OSHP, përkatësisht është nxjerr raport i ekspertizës me nr.12/22, pretendimet ankimore janë te njëjta në kemi dhëne propozimin tone, përderisa, paneli shqyrtues ankesën e njëjtë përmes vendimit te datës 05.08.2022, e ka hedhë si jashtë afatit për shqyrtim dhe nuk ka dhëne ndonjë obligim ndaj AK-Komuna Gjakove.

AK – Komuna Gjakove, pas pranimi te vendimit te PSH-se, me datën **27.07.2022**, publikon njoftimin për dhënie te kontratës, ndërsa me datën **29.07.2022**, publikohet njoftimi për nënshkrim te kontratës, rrjedhimisht tani me është lidhur dhe publikuar kontrata për këtë procedurë te prokurimit dhe atë me datën **28.07.2022**, te protokolluar me datën **28.08.2022**.

Parashtruesi i ankesës përmes kërkesës për ri shqyrtim te datës 28.07.2022, kërkon ri vlerësim te ofertave me pretendimet ankimore te njëjta si ne ankesën paraprake, ndërsa AK – Komuna Gjakove , përmes shkresës se datës se njëjte potencon se, kërkesa juaj për ri shqyrtim nuk do te trajtohet sepse, afati për shqyrtim i kësaj lende ka skaduar duke prezantuar dëshminë ueb faqes se OSHP-se, paraqitjen e ankese date **10.01.2022**.

- Pra kërkesa për ri shqyrtim ishte parashtruar me datën 19.12.2021
- Me datën 19.12.2021 është nxjerr vendimi – refuzimi i kërkesës
- Me datën 10.01.2022 është parashtruar ankesa ne OSHP.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues nuk mund te japë ndonjë propozim për mënjanim te dhënies se kontratës apo Ri vlerësim te ofertave ne kuptim te dispozitave te nenit 105, te LPP-së, pasi qe tani është e kontrata është e lidhur.

OSHP me datën 14.10.2022, i ka njoftuar AK dhe OE me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues nuk ka kthyer përgjigje se pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Grupi i operatoreve ekonomik ankues me datën 17.10.2022, kanë kthyer përgjigje në të cilën

pajtohen pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësit e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij e bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesa në këtë rast.

Duke marr për bazë faktin se AK – Komuna Gjakove, pas pranimit të vendimit të PSH-se, me datën **27.07.2022**, publikon njoftimin për dhënie të kontratës, ndërsa me datën **29.07.2022**, publikohet njoftimi për nënshkrim të kontratës, rrjedhimisht tani me është lidhur dhe publikuar kontrata për këtë procedurë të prokurimit dhe atë me datën **28.07.2022**, të protokolluar me datën **28.08.2022** dhe se aktiviteti i prokurimit në fjalë është vetëm duke u ekzekutuar.

Paneli shqyrtues konstaton se shkëputja e kësaj kontrate nga ana e OSHP-së do të jetë në dem të interes të përgjithshëm nga se tanimë jemi vetëm në muajin nëntor dhe nga dita në dite mund të ketë përkeqësim të motit, dhe se AK nuk ka kontrate për mirëmbajtjen e këtyre rrugëve rurale në zonat për të cilat ka të bëjë aktiviteti i prokurimit në fjalë.

Paneli shqyrtues me rastin e vendosjes dhe vendimmarrjes për rastin në fjalë mori parasysh gjendjen e krijuar, faktet e paraqitura, fund vitin dhe keqësimin e motit dhe mbi të gjitha mori parasysh interesin e përgjithshëm që ka të bëjë zhvillimi i aktiviteti të prokurimit në fjalë dhe kur krahasoj dhe analizoj të gjitha këto rrethana erdh në përfundim se pasojat negative që mund të ketë shkëputja e kësaj kontrate dhe pezullimi i aktiviteti të prokurimit në fjalë i tejkalojnë përfitimet e mundshme dhe dëmtimin e operatorit ekonomik ankues. Andaj si e tillë kontratat e lartcekur mbetet në fuqi.

Paneli Shqyrtues vendosi sikur në pikën 2 të dispozitivit, me qenëse pa fajin e tij, ky aktivitet ka përfunduar me lidhjen e kontratës, ndërsa PSH nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve të tij ankimore.

- Përfundim -

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 112 të Ligjit të cituar sipas të cilit duke marrë parasysh pasojat e mundshme negative që mund të ketë shkëputja e kontratës dhe pezullimi i aktivitetit të prokurimit në të gjitha interesat që mund të dëmtohen duke përfshirë interesin publik dhe interesat e ankuesit, ku bordi konstaton se pasojat negative që mund të ketë shkëputja e kontratës dhe pezullimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë i tejkalojnë përfitimet e mundshme andaj në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm len në fuqi kontratën e cekur si më lart.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit shqyrtues

Vedat Poterqoi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet;

1x1 AK – Komuna e Gjakovës

1x1 OE- "MERISA" SH.P.K. ; NTSH VIKTORY COM (Pjeter Qërimi B.I); AEK MUNELLA SHPK; ECO SWISS RECYCLING" me seli në Gjakovë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së